

V E N D I M
Nr.78, datë 14.2.1994

PER ÇMIMET E SHITJES SË KARBURANTEVE PËR INVALIDËT PARAPLEGJIKE

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Çmimet e shitjes me pakicë të benzinës e të vajit lubrifikant për invalidët paraplegjikë, që përdorin pajisje motorike sipas miratimit të Drejtorisë (degës) së Sigurimeve Shoqërore, caktohen:

-Benzinë(vendi)RON 70-85..... 1.5 lekë /litri

-Vaj SAE..... 22 lekë /kg

-Vaj Aftol..... 16 lekë /kg

2. Sasia vjetore e konsumit të benzinës e të vajit lubrifikant për pajisjet motorike që kanë në përdorim invalidet paraplegjike, caktohet nga Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Sigurimeve Shoqërore.

3. Efekti ekonomik deri në 8 milionë lekë për vitin 1994 përballohet nga diferencat e çmimeve për nënproduktet e naftës që korporata e Albpetrolit derdh buxhetin e shtetit mbi bazën e ligjit përkatës “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

4. Çdo akt tjetër nënligjor që bie në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 mars 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi